Ofrojmë Trajnimin SPPS

SPPS është shkurtesë për Paketë Statistikore për Shkencat Shoqërore (ang. Statistical Package for Social Science). Sot përdoret më shumë si "Statistical Product and Service Solutions" dhe shfrytëzohet nga të gjithë ata që kanë nevojë ta paraqesin punën e tyre përmes funksioneve statistikore.



20 të rinj trajnohen për Paketë Statistikore të Shkencave Sociale (SPSS)

Sot konsiderohet si një nga paketat statistikore më të popullarizuara, përmes së cilës mund të manipulojmë të dhëna të ndryshme dhe analizojmë duke ndjekur udhëzime mjaft të thjeshta. Njëzet (20) të rinj nga komuna e Vitisë do të përfitojnë nga trajnimi i paketës SPSS

Iniciativa “Praktiko, Mëso” në Viti mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Qëllimi i iniciativës

Qëllimi i iniciativës "Praktiko, Mëso" është që t'i nxisim të rinjtë ta sfidojnë zonën e tyre të rehatisë dhe ta kuptojnë potencialin e tyre.

Deri në fund të iniciativës **8 të rinj** nga komuna e Vitisë do të përfitojnë përvojë përmes punës praktike në sektorin privat.

Deri në fund të iniciativës **20 të rinj** nga komuna e Vitisë do të përfitojnë nga trajnimi Paketa Statistikore për Shkencat Sociale.

Çfarë është Puna Praktike?

Puna praktike ofron përvojë pune për fillestarët në një profesion të caktuar. Kjo përvojë jo vetëm që iu ndihmon atyre në aftësimin profesional, por njëkohësisht shërben edhe si mundësi për t'u njohur me mjedisin e punës dhe mundësitë që ofron ajo.

Puna praktike para fillimit të punës së rregullt ka shumë përfitime, pasi që të gjitha njohuritë teorike ushtrohen në praktikë. Kjo çon në rritje profesionale e poashtu edhe personale. Mundësitë për të zhvilluar përvojën janë kyçe drejt hulumtimit të tutjeshëm në mundësitë e karrierës dhe krijimit të rrjetit me njerëz nga fusha e interesit. Ajo se çka fiton nga puna praktike pjesërisht varet edhe nga ajo se sa investon në të.

8 të rinjëve iu ofrohet punë praktike

Iniciativa "Praktiko, Mëso" në komunën e Vitisë përmes sektorit privat në Kosovë iu ofron 8 të rinjve punë praktike në këta sektorë:

— Kuzhinieri
— Zdrukthtari
— Marketing
— Teknologji Informative